



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 9, datë 27.12.2018

MBI

NISJEN E PROCEDURËS PËR CAKTMIN E PËRKOHSHËM TË GJYQTARËVE TË GJYKATAVE PËR KRIMET E RËNDA NË GJYKATAT E POSAÇME PËR GJYKIMIN E VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor i mbledhur më datë 27.12.2018, mbështetur në nenet 135 dhe 179 të Kushtetutës, në nenin 162 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”,

V E N D O S I:

1. Të fillojë procesin e caktimit të përkohshëm në nivelin përkatës në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, të gjyqtarëve në detyrë të gjykatës së shkallës së parë për krimet e rënda dhe të apelit.
2. Gjyqtarët në detyrë të gjykatës së shkallës së parë për krimet e rënda dhe të apelit, të cilët vlerësojnë për të vijuar ushtrimin e detyrës së gjyqtarit pranë gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, duhet:
 - a) Të shprehin interesin me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor për të ushtruar detyrën pranë gjykatave të posaçme;
 - b) Gjyqtarët dhe familjarët e afërm të tyre të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe formularëve përkatës pjesë përbërëse e këtij ligji.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR